



Kuvendi i Kryeqytetit
Skupština Glavnog Grada –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 25.10.2023, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Faton Marolli.

Munguan: Trieri Kasumi Berisha, Adnan Ajeti, Arton Brahimi.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Klaudia Mula - zyrtare për komunitete nga ZKKK, Arianita Beqa Rraci - përfaqësuese nga UNMIK-u dhe përfaqësuesit e KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Takimi i KK-ës me përfaqësuesit e KFOR-it, UNHCR, BSK-ës, PK-ës dhe ZKKK-ës me qëllim të analizimit të gjendjes së sigurisë dhe lirisë së lëvizjes;
3. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, - Raport për gjendjen e nxënësve nga komunitetet joshumicë në shkolla;
4. Shqyrtimi i raporteve për vizitat në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë;
5. Raporti i ZKKK-ës për muajin shtator 2023;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitetë e tyre;
7. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-ës.

Mirsada Behluli – lidhur me ekstraktin e procesverbalit pati një vërejtje për të cilën u dakorduan me procesmbajtësen që ajo të përmirësohet.

Njëzëri u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Faqe 1 nga 6

Pika e dytë

Takimi i KK-ës me përfaqësuesit e KFOR-it, UNHCR, BSK-ës, PK-ës dhe ZKKK-ës me qëllim të analizimit të gjendjes së sigurisë dhe lirisë së lëvizjes.

Përfaqësuesi i KFOR-it – lidhur me pikën e rendit të ditës tha se ne vazhdimisht bëjmë patrullime nëpër fshatra dhe qytet, po ashtu edhe në fshatrat në veri ku mund të them se situata është e qetë dhe pa probleme. Ai në vazhdim tha se ne jemi në bashkëpunim të ngushtë me policinë e Kosovës, kështu që bashkëpunojmë me ta.

Nenad Miladinovic – tha se do të ishte mirë që edhe përfaqësuesit e Policisë së Kosovës të ishin prezent sot këtu. Unë gjithmonë më herët me krenari kam thënë se situata është shumë e mirë, e qetë ku edhe marrëdhëniet ndëretnike kanë qenë shumë të mira, mirëpo kohëve të fundit kanë qenë disa raste ku është shprehur njëfarë urrejtje, një provokim ku e gjithë kjo ka ndodhur në Bërnicë të Poshtme, ku më datë 29 të muajit të kaluar kemi pasur një rast ku një person i cili është endur andej me tabela me regjistrim të Serbisë në rrugën për Merdarë është provokuar të ndalet nga ana e dy veturave ku ajo ka ndodhur prej Lebanes deri në Lupç. Në fund vozitësi është ndalur në pompë të benzinës në Lupç. Personat të cilët e kanë përcjell kanë tentuar edhe në pompë të benzinës ta provokojnë dhe ta sulmojnë ku në fund është dashur të vjen policia dhe ta përcjell deri në Merdare. Ai në vazhdim tha se kemi pasur edhe dy raste në Bërnicë të Poshtme, janë sulmuar fëmijët në poligonin e shkollës ku aty ka dal policia në vendin e ngjarjes dhe ka bërë procesverbalin e rastit. Po ashtu kohën e fundit kemi probleme prej personave, të cilët besoj se nuk janë nga Bërnica ku i provokojnë femrat dhe fëmijët. Mund të them sinqerisht që deri tani nuk kemi pasur kësot probleme, mirëpo kohëve të fundit vërtet më brengos kjo çka po ndodh dhe desha t'i prezantoj.

Pika e tretë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, - Raport për gjendjen e nxënësve nga komunitetet joshumicë në shkolla.

Për shkak të mosprezencës së drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për ndonjë prej takimeve të radhës.

Pika e katërt

Shqyrtimi i raporteve për vizitat në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë.

Klaudia Mula – sa i përket raportit të vizitave në shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë, tha se kemi vizituar tetë shkolla, ku unë i kam nxjerr disa nga kryesoret që mendoj se duhet me i thënë këtu sepse reportin në detaje besoj se e keni lexuar. Por ajo çka vlen të theksohet dhe të ngritet zëri është tentim-braktisja e mësimit nga ana e nxënësve joshumicë nëpër shkolla. Ajo në vazhdim tha se në të gjitha shkollat numri i tentim-braktisjes së mësimit është dhjetë nxënës. Në shkollën fillore “Emin Duraku”; 2 nxënës të komunitetit ashkali, në shkollën “Model” apo “Qamil Batalli”; është një nxënëse e komunitetit ashkali, në shkollën fillore “Asim Vokshi”; kemi gjashtë nxënës të komunitetit ashkali dhe një nxënës i komunitetit boshnjak në shkollën fillore “Naim Frashëri”, ndërsa sa i përket kërkësave të shkollave, në shkollën “Emin Duraku” kemi pasur një shqetësim rrëth mosmirëmbajtjes së higjenës personale të nxënësve, gjë që ka ngritur shqetësimin edhe te mësuesit dhe të prindërve për shkak që fëmijët e tyre janë infektuar. Tute apo përmendi

Faqe 2 nga 6

Kerkesen e cila ka qene per nje kabinet te informatikes me me se paku tre kompjutere. Kerkesa tjeter nga shkolla "Asim Vokshi" duke u bazuar ne tentim-braktisjen e nxenesve ka qenë fushata sensibilizuese për prindërit, për regjistrim parashkollar dhe fillor, si dhe vetëdijesimin e tyre për bashkëpunimin prind - shkollë për vijueshmërinë dhe suksesin e nxenesve. Po ashtu edhe në shkollen "Elena Gjika" kemi pasur disa kërkesa, i kanë donatorët të cilët po i përkrahin për disa projekte, për shkak të ngecjes së disa procedurave nuk e dimë saktë ku ka ngecur, por do të ndërmarrim masa lidhur me këtë çështje që të realizohen këto projekte në të mirë të të gjithë nxenesve dhe të gjithë të tjerëve. Është projekt i përvendosjen e një objekti shtesë në shkollë për t'i vendosur pajisjet në kabinet të robotikës, edhe kanë një kërkesë për t'ua lejuar atë pjesën e aneksit të shkollës së muzikës që me e shfrytëzuar për klasë, për mësim plotësues etj. D.m.th këta i kanë donacionet, por vetëm ju duhen procedurat e lejimit, ndërsa sa i përket shkollës "Naim Frashëri" është një kërkesë specifike d.m.th që dy muaj nuk kanë mësimdhënës të lëndës së gjeografisë dhe edukatës qytetare, kurse është nevojë elementare d.m.th nuk kanë si t'i notojnë nxenesit me nota. Përveç kësaj kërkesë, ata kanë pasur edhe kërkesën tjetër që i përket pozitës së koordinatorit për të drejtat e komuniteteve në Drejtorinë e Arsimit që ka qenë e komunitetit boshnjak znj. Jasmina Omeragic, kurse pyeti se çka ka ndodhur me atë pozitë a është myllur ajo pozitë apo çka është bërë me atë pozitë, na jepni një sqaram.

Kimeta Shok - duke u ndërlidhur me çështjen e arsimtarit të gjeografisë dhe edukatës qytetare tha se ata janë strikt se komuna duhet të hapë konkursin, kur ata vijnë këtu ata ju thonë se këtë punë e ka Drejtoria e Arsimit. Prandaj shtroi pyetje përsë nuk është hapur konkursi, pasi qe dy muaj nxenesit janë pa arsimtarë.

Klaudia Mula – tha se kisha propozuar që këto shqetësime të hyjnë si konkluzion dhe të dërgohen në Drejtorinë e Arsimit prej përfaqësuesit të komunitetit boshnjak.

Mirsada Behluli – lidhur me çështjen e koordinatorit tha se me këtë çështje jam marr qysh derisa ka qenë z. Hetem Kupina këtu ku dhe kemi pasur probleme, ku së bashku me z. Hetem dhe z. Nenad iu kemi drejtuar Drejtorisë për Arsimit ku ata na kanë udhëzuar tek Zyra e Burimeve Njerëzore, në ç'rast më janë përgjigjur me një e-mail ku thuhet se pasi që ligji ka ndryshuar, gabimisht po thuhet koordinator për të drejtat e komuniteteve në mësimin e gjuhës boshnjake që ai vend është një zyrtar i lartë gjithëpërfshirës për të gjithë e që rastësisht znj. Omeragic tanë e ndjerë ka kryer punën e koordinatorit.

Pika e pestë

Raporti i ZKKK-ës për muajin shtator 2023

Klaudia Mula – sa i përket Raportit të muajit shtator 2023, tha se besoj se e keni marrë dhe lexuar të gjithë. Gjatë këtij muaji janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet e parapara me planin e punës të ZKKK-ës. Ajo në vazhdim tha se kisha dashur t'i cek dy projekte që janë implementuar gjatë këtij muaji dhe ato janë:

- Furnizimi me pakë shkollore për 155 nxenesit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës.
- Furnizimi me pakë ushqimore për 120 familje të të gjitha komuniteteve joshumicë që janë në gjendje të rendë ekonomike.

Sa i përket këtij projektit në mbledhjen e fundit të këtij komiteti i kam lexuar disa pakënaqësi lidhur me përpilimin e listave, mirëpo në këtë raport i keni të sruar të gjitha se si ka shkuar mënyra e përpilimit të listave. Në fund tha se nëse ka dikush të pyes diçka rreth kësaj çështjeje le të urdhërojë, unë jam e gatshme t'i përgjigjem.

Mirsada Beniu - duke iu drejtar znj. Mula tha se kisha me ju futur qe te na informoni ketu per çao gjë që ka lidhje me furnizimin me dru zjarri pér familjet që kanë nevojë. Pra çfarë eshtë qëndrimi i ZKKK-ës dhe drejtorive relevante.

Klaudia Mula – sa i pérket raportit tha se ky ka përfunduar pér muajin shtator.

Oktay Kurtesh - shتروي pyetje, prej atyre 120 familjeve sa familje tē komuniteteve joshumicë kanë përfituar t'i marrin pakot ushqimore dhe prej atyre 120 familjeve sa familje janë tē komunitetit turk, si dhe pse nuk eshtë publikuar sa pako kanë shkuar pér çdo komunitet.

Klaudia Mula – duke iu përgjigjur z. Kurtesh tha se tē gjithat janë tē shënuara në raport, pra pér komunitetin turk janë ndarë nëntë pako. Ajo në vazhdim tha se ZKKK si gjithnjë ka ndërmarrë tē gjitha hapat e nevojshëm dhe duke u bazuar në nevojat që ju i shfaqni në çdo takim ka iniciuar projektin trevjeçar pér me i furnizuar këto familje me pako ushqimore. Siç e dini ne si zyrë nuk kemi ndonjë buxhet pér këto projekte. Këto projekte shkojnë me kode buxhetore tē drejtorive tjera, por ne kemi marrë vullnetin që tē punojmë në këto projekte vetëm pér t'i përkrahur familjet e komuniteteve joshumicë, ku drejtoritë përkatëse na kanë lejuar që pér tri vjet çdo vit nga 120 familje tē furnizohen me pako ushqimore. Ajo njëherazi ceku se nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale kanë marrë listën e familjeve që janë me asistencë sociale, ndërsa pér pjesën tjetër të mbetur i kemi ftuar tē gjithë përfaqësuesit e komuniteteve pér t'i plotësuar ato. Pra tē gjithë kanë qenë këtu përveç përfaqësuesit të komunitetit serb z. Nenad ku u dakordua dhe u përpilua lista, ndërsa sa i pérket komunitetit serb ne si zyrë i kemi tē dhënat pér familjet tē cilat kanë nevojë, ku në mungesë tē përfaqësuesit i kemi futur emrat dhe eshtë plotësuar numri i 120 familjeve. Kjo ka qenë procedura e përpilimit tē listave edhe dy vitet e ardhshme do tē implementohet nëse ju mendoni se ka ndonjë formë më tē mirë pér juve jeni tē mirëseardhur pér t'i dhënë.

Oktay Kurtesh – tha se nuk eshtë në rregull që komuniteti turk t'i marrë vetëm tetë pako, se vetëm një familje eshtë në listën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Klaudia Mula - tha se kisha dashur me cek edhe diçka, kur kemi pasur mundësi me i përkrahur më shumë familje ne nuk kemi kursyer asgjë i kemi furnizuar tē gjitha familjet, kurse këtë vit e kemi pas tē kufizuar. Tani edhe dy vite ekziston kontrata pér ato lista, prapë edhe 120 familje do tē furnizohen. Unë kisha me ju propozuar që pér vitin e ardhshëm tē koordinohemi dhe tē ndahemi tē gjithë tē kënaqur, me rëndësi eshtë tē marrin ata që kanë nevojë.

Nenad Miladinovic – tha se në takimin e fundit kam kërkuar që ZKKK tē më sjell listën me emra tē familjeve tē cilat marrin ndihmë sociale, ajo listë nuk më eshtë sjell. Pastaj në takimin e kaluar unë kam shprehur pakënaqësinë time se në çfarë mënyre eshtë duke u shpërndarë ndihma sociale në kohën e fundit. Ai në vazhdim tha se unë mendoj se në atë mënyrë nuk do tē ishte dashur tē bëhet ndarja e ndihmave, nëse veç veprojmë kështu le ta merr atëherë Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe ta bëjë ndarjen e atyre ndihmave e mos tē na mundoj neve sepse mendoj se kjo nuk eshtë reale. Ne e kemi pasur listën ata tē cilët marrin ndihmën sociale edhe në atë listë nuk kanë hyrë emrat tē cilët ne i kemi dhënë këtu dhe çdo përfaqësues i ka dhënë emrat e familjeve tē cilat vërtet kanë nevojë pér ndihmë dhe këso probleme nuk kemi pasur. Unë vetë kam qenë i kyçur dhe e di se në mënyrë shumë reale eshtë bërë ndarja e ndihmave.

Klaudia Mula – tha se siç e potencova në fillim ne nuk kemi buxhet me bërë këso projekte. Projektet shkojnë me buxhet tē drejtorive përkatëse dhe ne duhet t'i respektojmë direktivat e tyre, ndërsa sa i

Faqe 4 nga 6

perket listes rammjet e komunitetit serb që marrin asistence sociale, une ju kam prezantuar ate oite ne takim. E kam lexuar emër për emër se cilën familje që merr asistencë sociale, lista është në zyrë, nuk e kam ditur që ju e keni kërkuar listën, por mund të vini në zyrë, mirëpo atë listë po ashtu mund ta merrni ardhshëm, ne besoj se do të bashkëpunojmë qysh juve ju duket më e arsyeshme dhe më mirë duke respektuar legjislacionin në fuqi. Ne jemi gjithmonë për bashkëpunim dhe për më të mirën për komunitetet.

Nenad Miladinovic – tha se më intereson nga kjo listë prej 120 familjeve sa prej tyre janë që marrin ndihmë sociale.

Klaudia Mula – tha se nuk jam e sigurt, por listën e kam në zyrë nuk mund të jap shifra jo të sakta, më duket janë diku 78 vetëm ashkali. Po deshët mund të shkoj ta marr.

Faton Marolli – tha se ka edhe më shumë në listë, por numri i kufizuar është 120 familje e nuk kemi mundur ta bëjmë 130 sepse është dashur ta reduktojmë numrin.

Klaudia Mula - tha se kisha me propozuar që të dalim me një çështje tjetër që ka të bëjë me dru zjarri dhe që është më e rëndëssishme pasi që ky projekt ka përfunduar. Ajo të pranishmit i informoi se dje ka marr një e-mail nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, ku njëherazi ceku se më herët janë shpërndarë nga tri metra dru për disa familje që marrin asistencë sociale. Ne e kemi marrë listën se cilat familje i kanë marrë nga tri metra dru. Aty kam parë që diku 17 familje janë të komunitetit ashkali, kurse tanë kemi kërkesë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale që të përpilohet një listë me 50 familje të të gjitha komuniteteve joshumicë si subvencion për blerjen e druve për ngrohje, listë për ndarjen e mjeteve financiare nga 200 euro. Lista duhet të përpilohet nga përfaqësuesit e komuniteteve, prej 50 familjeve dhe të dorëzohet në Drejtorenë e Mirëqenies Sociale, pastaj deri më datën 3 të muajit të ardhshëm do të përfundohen listat, emrat dhe xhirollogaritë e verifikuara të atyre familjeve, të cilat do të dorëzohen në Drejtorenë e Mirëqenies Sociale.

Nenad Miladinovic - tha se mendoj se është pak numri 50 familje për dru zjarri, mirëpo kisha propozuar që nga ato 50 familje, të shkojnë për 17 familje të komunitetit ashkali pasi që ata vërtet kanë numër të madh për ndihmë sociale, nga dhjetë të shkojnë për komunitetin serb dhe komunitetin turk, nga pesë të kenë komunitetet boshnjak dhe goran dhe tri familje të komunitetit rom.

Klaudia Mula – pas shumë diskutimesh dhe sugjerimesh tha se është një rregullore ku edhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale i pranon rastet sociale në bazë të saj.

Pika e gjashtë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitet e tyre.

Kimeta Shok – sa i përket gjendjes së sigurisë nuk kam se çka të them sepse nuk kemi probleme.

Nenad Miladinovic - tha se sa i përket sigurisë unë kam dekluaruar, ndërsa sa i përket marrëdhënieve ndëretnike dhe njerëzore në Bërnicë të Poshtme janë shumë të mira përveç asaj që e ceka më herët.

Oktay Kurtesh – sa i përket gjendjes së sigurisë tha se nuk kemi probleme.

Faton Maroli – sa i perket sigurise tha se nuk kemi probleme krejt eshte ne rregulli.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Kimeta Shok – shtroi shqetësimin e nxënësve në gjuhën boshnjake të cilët qe dy muaj nuk kanë profesor të gjeografisë në gjuhën boshnjake dhe kërkojnë që ky problem t'ju zgjidhet.

Nenad Miladinovic – shtroi shqetësimin lidhur me deponitë ilegale në Bërnice të Poshtme, në ç'rast tha se kam vërejtje tek Drejtoria e Shërbimeve Publike pasi që ndoshta për të njëqindën herë kërkoj që ajo të pastrohet.

Oktay Kurtesh – tha se në pjesën ku jeton komuniteti turk kemi mbetur si të prapambetur apo të lënë anash, pasi që në këtë pjesë nuk investohet thuajse asgjë.

Mirsada Behluli – të pranishmit i informoi lidhur me pagesën e mëditjeve se para dy muajve i jam drejtuar Kryetarit të komunës z. Përparim Rama me një e-mail ku edhe ai është i njoftuar lidhur me këtë. Po ashtu edhe Betimi i është drejtuar dy herë kabinetit dhe Zyrës ligjore, mirëpo nuk kemi marrë ende informata. Pas shumë diskutimesh, propozimesh dhe sugjerimesh Komiteti për Komunitete nxori këto:

R E K O M A N D I M E

1. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, - znj. Besianë Musmurati (U.D Donjeta Sahatçiu);
2. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale, - z. Krenar Xhaferi;
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Sportit, - z. Granit Rugova;
4. Ftesë për drejtorinë e Drejtorisë së Shëndetësisë, - z. Izet Sadiku;
5. Të njoftohet drejtori i Drejtorisë së Sigurisë në Komunën e Prishtinës lidhur me rastin e paraqitur nga z. Nenad Miladinovic, në Bërnice të Poshtme.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuese e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

